

Shoku Mikel Gjika me telin Nr. 720, date 5. 5. 1987, nga New-

Yorku njofton:

Ne emisionin e dites se premtë, pasi beri nje neokrollogji te shkelqyer per A. Kondon dhe e vendosi ne altarin e deshmoreve te kombit, Zef Camaj akuzoi hapur Sigurimin Shqiptar per vrasjen e tij. Tha se haku i tij do te merret e demaskoi udheheqjen tone, se ne emisionet e ardheshme do te ekspozoje materialet perkatese per kete krim te kryer nga qeveria shqiptare.

Ne fakt nuk dha asnje gje te tille me vone, per transmetoi nje reportazh personal, siç duket i trembur, kur akuzoi perseri titullarin tone e shoket e tjere, se po pergatit planin per denimin e tij me vdekje. Kercenoi se po t'i ndodhe gjesendi atij ose lidhjeve te tij do te hakmerret me çdo mjet. Pas akuzave qe beri ndaj nesh, per vrasjen e A. Kondos, shume shqiptare e kosovare pro nesh, shprehen indinjate te thelle ndaj tij dhe siç duket ndokush duhet ta kete kercenuar terthorzi ose hapur per veprimtarine e tij te poshter kunder nesh, gje qe e ka trembur shume dhe per te dale perpara ndonje veprimi, qe ai mendon se do te merret kunder tij, kercenon i ekspozuar se ka marre masa mbrojtese, i ka derguar ultimatum udheheqesit tone, atij jugosllav e atij vendas dhe po t'i ndodhe gje do te ngarkohet me pergjegjesi Misioni tone.

Mundet qe UDB-a ta ndjeke kete situatë e te krijojë ndonje provokacion, qofte edhe duke vepruar ndaj Zefit, per te akuzuar organet tona per veprimtari terroriste kunder nacionalistëve shqiptare.

Shoket do bejne kujdes te veçante ne pune dhe me kontaktet me emigracionin kosovar. Dy emisionet e fundit jane regjistruar dhe do dergohen me rastin me te pare.

Teli eshte pare nga shoku Minister per pa shenim.

Shoku Razip Leli shenon: Deges VI-te

Nxori J. Proko, date 9. 5. 1987